



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

**SHËNIM ZYRTAR NR.14/2019**

**Nga takimi i komisionit me përfaqësues të MCC-së (Korporata Sfidat e Mileniumit)**

**Datë 20.2.2019, ora 15:00, salla N-10, ndërtesa e Kuvendit, Prishtinë**

**Pjesëmarrës nga anëtarët e komisionit:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Muharrem Nitaj dhe Veton Berisha.

**Delegacioni nga MCC (SHBA):** Karen Sessions, zëvendëspresidente e Kongresit dhe Çështjeve Publike; Jonathan Brooks, udhëheqës për Evropë, Azi, Paqësor dhe Amerikë Latine; Michelle Cigaurrista, Laura Allen, MCC, dhe Sarah Olmstead, MCC, Kosovë, si dhe Petrit Selimi, drejtor i Fondit të Kosovës të Mileniumit.

**Kryetarja**, fillimisht, i përshëndeti përfaqësuesit e MCC-së, si dhe i prezantoi anëtarët e komisionit. Ajo paraqiti një historik të shkurtë të punës së komisionit. Më tutje, duke u lidhur me temën e takimit, ajo informoi se sapo jemi kthyer nga takimi i radhës i Plenumit parlamentar të Komunitetit të Energjisë. Në këtë takim të plenumit, u diskutua për eficientësinë e energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë, si dhe çështje të tjera të fushës së energjisë. Kryetarja falënderoi përfaqësuesit e MCC-së dhe shtetin amerikan, që e kanë zgjedhur Kosovën për ta ndihmuar në fushën e energjisë.

**Karen Sessions**, njoftoi anëtarët e komisionit, se Kosova është kualifikuar për ndihma nga MCC. Zyra e Kryeministrit do të krijojë një ekip të vogël, që t'i përmbushin nevojat që kërkohen për zbatim të programit. Marrëveshja për programin kompakt, kërkon edhe ratifikimin në Kuvend. Shpresojmë se ekipi do t'i identifikojë dhe do t'i hartojë projektet që do të për zgjidhen. Presim ta kemi mbështetjen e juaj për programin kompakt dhe MCC.

**Jonathan Brooks**, sqaroi se MCC është një agjenci e re, e cila vepron mbi parime kyçe. Partneriteti me Kosovën për programin varet nga rezultatet, sepse rezultatet janë shumë të rëndësishme, pasi që aty ku ka rezultate, aty do të jepet mbështetje. Mbështetja do të jetë në energji, qeverisje të mirë dhe duhet të bashkëpunojmë ngushtë. Për neve është e rëndësishme të takohemi me qeveritarë, parlamentarë, biznese dhe jemi të interesuar të mësojmë, si organizatë, për nevojat e Kosovës, për projektet që mendojnë të përfshihen në program.

**Petrit Selimi**, sqaroi se marrëveshja është nënshkruar gjatë Qeverisë së kaluar, ku projektet kanë qenë në izolim të objekteve. Tash kemi edhe projekte nga programi kompakt. Ekipi i ri do të punojë paralelisht me projekte të programit kompakt, me 49 milionë euro, që do të ndahen për 5 vjet dhe brenda 5 vjetëve duhet të realizohen projektet. Nëse këto projekte nuk realizohen, mjetet do të kthehen prapa.

**Sarah Olmstead**, theksoi se do të ishte mirë të marrim informacione se çfarë projektesh të mundshme do të propozohen.

**Kryetarja** theksoi se sfida është zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi ekonomik nuk mund të ndodhë pa pasur energji të mjaftueshme dhe të sigurt. Po ashtu, orientimi në efikasitet të energjisë dhe burime të ripërtëritshme të energjisë, përmes këtij programi do të ishte shumë i mirëseardhur.

**Hykmete Bajrami**, falënderoi përfaqësuesit e MCC-së për ardhjen e tyre në Kosovë. Ajo theksoi se kam qenë pjesë e Qeverisë, kur ka filluar projekti me MCC-në. Shumë reforma janë bërë në politika fiskale, por kur vjen çështja të energjia, është sfiduese. Ka shumë barriera për biznese, ku është edhe furnizimi me energji dhe çmimi i energjisë. Ne jemi pjesë e Komunitetit të Energjisë dhe kemi obligim për të zbatuar legjislacionin e Komunitetit të Energjisë, prandaj mbështetja e MCC-së në fushën e energjisë është shumë e mirëseardhur. Qasja në rrjetin e gazit do të ishte projekt shumë i mirë. Ne do ta ratifikojmë marrëveshjen me MCC-në.

**Jonathan Brooks**, e falënderoi deputeten Bajrami për gatishmërinë për të ratifikuar marrëveshjen me MCC-në. Ai theksoi se ekziston një bollëk i informacioneve dhe do ta keni në dispozicion.

**Karen Sessions**, theksoi se në këtë takim po vijmë nga një aktivitet për gratë në sektorin e energjisë, për edukim në energji, ku do të jepen bursa për studim dyvjeçar në Amerikë për 25 gra. Presidenti Trump ka lansuar një projekt për gratë në ekonomi. Për programet që i zhvillojmë, rezultatet janë kryesore, për të demonstruar investimin tonë. Përzgjedhja e projekteve bëhet nga bordi, i kryesuar nga Mike Pompeo. Dëshirojmë që programi të kryhet brenda 5 vjetëve.

**Dardan Sejdiu**, theksoi se është një lajm i mirë për vendin tonë që jemi pjesë e këtij programi dhe që do të na mbështetni në projekte me rëndësi për vendin. Lidhur me edukimin për energji, do të ishte mirë të na ndihmoni me një mënyrë të mirë të edukimit për efikasitet të energjisë. Po ashtu, edhe projektet në sisteme të ngrohjes janë shumë të mira. Për qytetet e mëdha do të duhej të mbështetesh mobiliteti në kuptim të efikasitetit të energjisë. Të krijojmë mundësi për mobilitet të integruar, hibrid, që zvogëlon ndotjen. Digjitalizimi i gjykatave është i rëndësishëm dhe të krijohet mundësia që të gjenerojnë llogaridhënie dhe prezantim të performancës së gjykatave, si dhe të krijohet transparencë. Po ashtu, edhe digjitalizimi në arsim do të ishte i mirëseardhur, sepse nxënësit e vegjël po bartin çanta me pesha të mëdha, si dhe digjitalizimi do t'i mundësojë të jenë në hap me nxënësit e vendeve të zhvilluara.

**Karen Sessions**, theksoi se idetë si mobiliteti, digjitalizimi janë ide që shkojnë krah për krah. Qasja në informacion duhet të jetë moderne. Edukimi është i rëndësishëm.

**Muharrem Nitaj**, theksoi se Kosova është shumë me fat që është pjesë e këtij programi. Në informacion është thënë se 22 milionë dollar do të investohen për

renovimin e shtëpive për efikasitet të energjisë. Cila do të jetë formula e përzgjedhjes së këtyre shtëpive?

**Petrit Selimi**, sqaroi se do të përzgjidhet një kompani ndërkombëtare që do ta bëjë modelin për përzgjedhjen e shtëpive. Gjashtë komuna do të mbështeten në renovim të pallateve me efikasitet të energjisë.

**Hykmete Bajrami**, theksoi se duhet të fillohet me fushatë për edukim në efikasitet të energjisë, sepse qytetarët nuk e dinë si mund të kursehet energji, sepse siç e dimë, vetëm me ndërrimin e poqëve mund të kursejmë energji. Po ashtu, të bashkëpunohet me Fondin për Garanci Kreditorë, në mënyrë që të mbështeten kreditë për investime në efikasitet të energjisë.

**Kryetarja** theksoi se edhe me Fondin për Efikasitet të Energjisë duhet të bashkëpunohet. Po ashtu, instalimi i pajisjeve për matjen e cilësisë së ajrit është shumë i rëndësishëm, sepse do të gjenden rezultatet se nga vjen ndotja, prej cilëve ndotës më shumë, a prej transportit apo prej termocentraleve apo prej ndotësve tjerë.

*Të dyja palët e vlerësuan të frytshëm këtë takim, ku u shkëmbyen pikëpamje për projektet dhe zbatimin e programit kompakt për Kosovën, si dhe ofruan gatishmëri për të ratifikuar marrëveshjen dhe për të mbështetur realizimin e këtij programi.*

Përgatiti:

Njësia mbështetëse e komisionit.